

VENDIM
Nr. 58, datë 2.4.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 303, DATË 23.10.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘IDI 2005’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ‘TEKSOEN 1’”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 709/2 prot., datë 25.3.2024, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 303, datë 23.10.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Teksoen 1’”.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 303, datë 23.10.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 30-vjeçar, duke i lënë kusht shoqërisë të informojë ERE-n, çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 26.10.2024.

- Në kuadër të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 2, të vendimit të Bordit, ERE, me shkresën nr. 709 prot., datë 23.2.2024, i kërkoi shoqërisë informacion në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, pasi shoqëria nuk kishte informuar sipas afatit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit të Bordit nr. 303/2023, me shkresën e depozituar në ERE nr. 709/1 prot., datë 4.3.2024, shoqëria na informoi se ka nisur punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik.

- Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit nr. 303, datë 23.10.2023, i cili vlerësohet që të shfuqizohet. Me shfuqizimin e pikës 2, nuk gjen vend as pika 3, si e tillë shfuqizohet dhe pika 3 e këtij vendimi.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 303/2023, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë e Bordit të ERE-s. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi